



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

V E N D I M

Nr. 171, Datë 14/09/2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”¹, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr.157, datë 12.08.2021, e z. A.Gj., ku pretendohet diskriminim, për shkak të gjendjes shoqërore² dhe për çdo shkak tjetër, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

Pas shqyrtimit fillestar të ankesës së mësipërme, Komisioneri³,

K O N S T A T O I:

I. Pretendimet sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, ankuesi A.Gj., i datëlindjes 24.02.1977, lindur në Rrëshen, Mirditë dhe banues në Tiranë është punonjës i Policisë së Shtetit me gradën “Kryekomisar”. Në vitin 2017, ankuesi ka mbajtur pozicionin e Shefit të Komisariatit të Policisë Gjirokastër dhe në funksionin që mbante i takonte grada “Drejtues”, ndërkohë që mbante gradën “Kryekomisar”.

¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

² Shkaku i diskriminimit të pretenduar u përcaktua pas depozitimit të ankesës, në vijim të e-mailit të dërguar nga Komisioneri.

³ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

Ankuesi pretendon se ka kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit që t'i njihej grada "Drejtues", por një kërkesë e tillë i është refuzuar. Në këto kushte, ai ka depozituar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, kërkesë-padinë me objekt – detyrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit që t'i njohë gradën "Drejtues". Me Vendimin nr. 182, datë 28.03.2017, gjykata e sipërcituar ka vendosur për pranimin e kërkesëpading dhe detyrimin e palës së paditur Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për t'i njohur paditësit gradën "Drejtues". Vendimi i sipërpërmendur nuk është ankimuar pranë Gjykatës së Apelit Administrativ nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe si rrjedhim ky vendim ka marrë formë të prerë në datën 12.04.2017.

Z. A.Gj. sqaron se në vijim ka dërguar kërkesën nr. A-234, datë 25.09.2018, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nëpërmjet së cilës ka kërkuar që t'i jepet grada "Drejtues" sipas vendimit gjyqësor të sipërcituar. Me shkresën nr. 689/2-A, datë 02.10.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është shprehur se fitimi i gradës bëhet nëpërmjet konkurimit, sipas neneve 53 dhe 59, të ligjit nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit", si dhe e bën me dije se nëpërmjet Urdhërit nr. 7039, datë 13.09.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit është hapur procesi i konkurimit për gradat "Komisar", "Kryekomisar" dhe "Drejtues", faza e aplikimeve në bazë të së cilit, kishte filluar në datën 13.09.2018 dhe përfundonte në datën 10.10.2018. Ankuesi pretendon se konkurimi sipas këtij urdhëri nuk është zhvilluar dhe pozicionet me gradën "Drejtues" mbulohen nga punonjës policie me grada më të ulëta, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 108/2014 "Për Policinë e Shtetit". Ankuesi shprehet se Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit nuk e ka përmbushur detyrimin e saj, që rrjedh nga zbatimi i vendimit gjyqësor as nëpërmjet veprimeve përmbartimore të kryera nga përmbartuesi Sh. A.

II. Procedurat e ndjekura nga Komisioneri

Pas verifikimit fillestar ta ankesës, Komisioneri konstatoi se ankuesi nuk kishte përcaktuar shkakun e diskriminimit të pretenduar. Në këto kushte, KMD iu drejtua ankuesit me e-mailin e datës 12.08.2021, ku i kërkoi informacion mbi shkakun e diskriminimit.

Ankuesi dërgoi informacion pranë KMD-së, nëpërmjet e-mailit të datës 15.08.2021, ku informon se vendimi nr. 182, datë 28.03.2017, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, që i njehej atij gradën "Drejtues" nuk është zbatuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ndërkohë që vendimet gjyqësore të së njëjtës gjykatë, të dhëna përgjatë së njëjtës periudhë kohore, që u kanë njohur gradën "Drejtues" kolegëve të tij G. M., A. D., B. A., G. Zh. dhe D. L., janë zbatuar nga ky institucion. Ankuesi pretendon se diskriminohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, pasi ai është nga veriu i Shqipërisë, ndërkohë që kolegët e tij janë nga jugu i Shqipërisë. Një arsytim të tillë, ai e mbështet në faktin se drejtuesi i DPPSH

është nga jugu i Shqipërisë dhe mbështet ata punonjës që janë nga kjo pjesë e Shqipërisë. Në vijim ankuesi pretendon se ky institucion në shenjë hakmarrjeje ndaj tij e ka liruar nga detyra e Shefit të Komisaritit Gjirokastrë dhe në datën 08.05.2017 e ka emëruar në një detyrë më të ulët, në gradën “K/Komisar”, në Kukës.

Mbështetur në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se:

Ligji nr.10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të “etnisë”, “moshës” dhe “për çdo shkak tjetër” duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 3, i ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Në nenin 12, pika 1, gërma a), b) dhe c), të LMD, i ndryshuar, parashikohet se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: a) shpalljen e vendeve të lira të punës; b) rekrutimin dhe përzgjedhjen e punëmarrësve; c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Mbrojtja nga diskriminimi, sipas nenit 7, të LMD-së, së ndryshuar, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata

ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Në nenin 33, pika 4, gërmat dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, parashikohet se nuk pranohen ato ankesa kur: (2) paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese.

Për sa më sipër, KMD vë në dukje faktin se vendimi nr. 182, datë 28.03.2017, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër ka marrë formë të prerë në datën **12.04.2017**. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit jo vetëm nuk ka marrë masa për zbatimin e tij, por e transferon ankuesin në një detyrë tjetër (më të ulët në gradë nga ajo e fituar me vendim gjyqësor) në qytetin e Kukësit, në datën **08.05.2017**. Komisioneri gjykon se këto momente, të cilat kanë largësi kohore më pak se 1 muaj nga njëra tjetra, konsistojnë me momentin e ndodhjes së diskriminimit të pretenduar nga ankuesi. Ankesa e drejtuar pranë KMD-së daton në **12.08.2021**. Në këtë kontekst, Komisioneri konstaton se momenti, kur ka ndodhur diskriminimi i pretenduar, daton më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit.

Njëkohësisht, ankuesi ka depozituar kërkesën nr. A-234, datë 25.09.2018, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, nëpërmjet së cilës kërkohet zbatimi i vendimit të tij duke i dhënë gradën përkatëse. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit është dërguar shkresa nr. 689/2-A, **datë 02.10.2018**, ku informohet se titulli fitohet nëpërmjet konkurimit etj. Komisioneri gjykon se ky është momenti, kur ankuesi ka marrë dijani mbi diskriminimin e pretenduar, pasi nëpërmjet kësaj shkrese, ky institucion nuk ka marrë përsipër zbatimin e vendimit dhe nuk shprehet se do ta zbatojë këtë vendim, por e orienton ankuesin të konkurojë sipas Urdhërit nr. 7039, datë 13.09.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shteti. Në vijim ankuesi nuk ka patur letërkëmbim zyrtar me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Edhe në këtë kontekst, Komisioneri çmon se ankesa është depozituar më shumë se dy vjet nga momenti i marrjes dijani mbi diskriminimin e pretenduar.

Mbështetur në dispozitën e sipërpërmendur, Komisioneri nuk e pranon për shqyrtim ankesën nr.157, datë 12.08.2021, e z. A.Gj., pasi është jashtë afateve ligjore për t’u shqyrtuar nga ky institucion, por rekomandon që ankuesi të depozitojë kërkesëpadi me objekt konstatim diskriminimi pranë gjykatës kompetente⁴, pasi është ende brenda afateve ligjore, që çështja e tij

⁴ Referuar nenit 36/1, të LMD, të ndryshuar, ku parashikohet: “1. Padia i paraqitet gjykatës kompetente nga një prej subjekteve të parashikuara në nenin 34 të këtij ligji jo më vonë se 5 vjet nga dita që ka ndodhur sjellja e pretenduar diskriminuese dhe jo më vonë se 3 vjet nga dita që i dëmtuari merr dijani për këtë sjellje.”

të shqyrtohet gjyqësisht. Në çështje të tilla, Komisioneri thirret nga gjykata në cilësinë e palës së tretë, për të dhënë mendim mbi objektin e shqyrtimit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 91, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative, nenin 7, pika 3, nenin 12, pika 1, gërma a), b) dhe c), nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), nenin 33, pika 4, gërma dh), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës nr.157, datë 12.08.2021, e z. A.Gj., pasi është depozituar jashtë afateve ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

Fusha – Punësim
Shkak – gjendja shoqërore, cdo shkak tjetër;
Lloji i vendimit - mospranim